

VENDIM
Nr. 551, datë 28.9.2023

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “KRIJIMI I NJË PARKIMI MAKINASH PRANË URËS SË VJETËR TË
GORICËS”, BASHKIA BERAT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Krijimi i një parkimi makinash pranë Urës së Vjetër të Goricës”, Bashkia Berat.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Berat.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall”, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 853 332 (tetëqind e pesëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e dy) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 853 332 (tetëqind e pesëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e dy) lekësh, përballohet nga Bashkia Berat.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Bashkia Berat.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Bashkisë Berat.

8. Bashkia Berat kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Berat.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi, në favor të Bashkisë Berat.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi, në favor të Bashkisë Berat.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Berat, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat, dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyj në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME PRONË PRIVATE E TË CILËVE,
SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA REALIZIMI I PROJEKTTT “KRIJIMI I NJË PARKIMI
MAKINASH PRANË URËS SË VJETËR TË GORICËS”, BASHKIA BERAT

Nr. rendor	TË DHËNAT E PRONARIT	TË DHËNAT KADASTRALE				TË DHËNAT E SHPRONËSIMIT					ADRESA	Shënime
	Emër/Atësi/Mbiemër	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sipërfaqe totale e parcelës (m²)	Zëri kadastral	Volumi	Faqe	Sipërfaqe shpronësim (m²)	Çmimi në lek (m²)	Vlera totale e tokës në lekë	Bashkia	
1	Pavlo Kristaq Kusta	8502	4/307	20.4	Truall	15	139	20.4	4183	85,333.00	Berat	Konfirmuar nga ASHK-ja
2	Filip Anastas Sinjari Thimi Anastas Sinjari	8502	4/308	183.6	Truall	15	138	183.6	4183	767,999.00	Berat	Konfirmuar nga ASHK-ja
Vlera totale										853,332.00		